



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 52, Datë 02.04.2024

MBI

**LËSHIMIN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA IMPIANTI FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT, HEC “VAU
I DEJËS”, I SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE
(KESH)” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 198/11 prot., datë 29.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, i shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH)” sh.a.,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 198, datë 22.01.2024, shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH)” sh.a., ka paraqitur kërkesën për lëshimin e Garancisë së Origjinës (GO) për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, për vitin 2023, duke paraqitur të dhënat përkatëse për secilin muaj.
- Me vendimin nr. 164, datë 15.05.2023, bordi i ERE-sa ka vendosur të lëshojë Certifikatën e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës” për periudhën 13.05.2022 – 31.12.2022.

- Referuar nenit 14.2 të *Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme*, miratuar me vendimin e bordi të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për Certifikatë Garancie Origjine do të depozitohet për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.
- ERE, me shkresën nr. 198/5 prot., datë 08.02.2024, ka kërkuar nga shoqëria “KESH” sh.a. informacion nëse ka pasur ndonjë ndryshim të dokumentacionit të depozituar nga ana e saj në kuadër të pajisjes për herë të parë me GO për këtë impiant.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 198/7 prot., datë 07.03.2024, shoqëria “KESH” sh.a. ka bërë me dije se nuk ka asnjë ndryshim të dokumentacionit respektiv nga ai i depozituar për lëshimin e GO për herë të parë për këtë impiant.
- Mbështetur në përcaktimet e nenit 22, pika 6 të ligjit nr. 24/2023, me shkresën nr. 198/4 prot., datë 02.02.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, numrin serial të aparatit matës dhe leximin e datës 1 të secilit muaj të kësaj periudhe.
- Shoqëria OST sh.a. ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 198/6 prot., datë 08.02.2024, ka dhënë informacionin përkatës për aparatet matës dhe ka paraqitur në formë tabelare sasinë faktike e energjisë të injektuar në rrjetin e transmetimit nga ky impiant, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, të ndarë në muaj.
- Për sa më sipër vlerësohet dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë e prodhuar nga impianti fotovoltaiik në Digën e Qyrsaqit, HEC Vau i Dejës, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, sipas sasive të dhëna nga shoqëria OST sh.a., duke iu referuar dhe përcaktimeve të pikave 11.2 dhe 11.3 të Rregullores, ku parashikohet se Garancia e Origjinës lëshohet për një njësi të energjisë elektrike prej 1 MWh.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pika 5 të ligjit nr. 24/2023: *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaiik në Digën e Qyrsaqit, HEC “Vau i Dejës”, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, e ndarë sipas muajve, si vijon:

a) Janar	360	MWh
b) Shkurt	555	MWh
c) Mars	636	MWh
d) Prill	702	MWh
e) Maj	755	MWh
f) Qershor	804	MWh
g) Korrik	964	MWh
h) Gusht	853	MWh
i) Shtator	740	MWh
j) Tetor	616	MWh
k) Nëntor	279	MWh
l) Dhjetor	277	MWh

2. Sasia totale vjetore e energjisë elektrike e prodhuar nga ky impiant është 7.541 MWh.
3. Garancia e origjinës e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijoni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI